

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
Departamenti: AGROEKONOMI
Drejtimi: Ekonomi e Bujqësisë dhe Ushqimit



PUNIM DIPLOME

(Studime Master)

**ROLI I KONTABILITETIT NË MENAXHIMIN E NDËRMARRJEVE
BUJQËSORE**

Mentorja:

Prof. Asoc. Dr. Jehona Shkodra

Kandidati:

Besnik Aliu

Prishtinë, Qershor 2023

Abstrakt

Ky hulumtim kuantitativ me dizajn deskriptiv, ka pasur për qëllim të identifikoj rolin e kontabilitetit në menaxhimin e ndërmarrjeve bujqësore në Kosovës. Është aplikuar metoda e thjeshtë jo-probable në përzgjedhjen e mostrës së hulumtimi, të përbërë nga 150 pjesëmarrës, udhëheqës dhe kontabilistë të ndërmarrjeve bujqësore. Efekti i informacionit kontabël, masa e ndikimit të tij, roli i kontabilitetit në zgjedhjen e problemeve të mundshme, si dhe vlerësimi i qëndrimeve të drejtuesve dhe kontabilistëve të ndërmarrjeve biznesore, ishin disa nga pyetjet që janë adresuar nga pyetësi i vet-hartuar dhe administruar me pjesëmarrësit e hulumtimit. Si rrjedhojë, të gjeturat e këtij hulumtimi në kontekstin kosovar, mbështeten edhe nga evidencat e tjera shkencore, me ç' rast, nga rezultatet konfirmohet se kontabiliteti iu ka ndihmuar rreth 94.7% në menaxhimin e biznesit të tyre bujqësor, 65.30% e pjesëmarrësve të hulumtimit konsiderojnë se e vlerësojnë shumë efektin e informacionit kontabël në menaxhim, mbi 50% e pjesëmarrësve u deklaruan se informacioni kontabël ndikon në masë shumë të madhe dhe rreth 87% e tyre kanë bërë zgjidhje të problemeve të identifikuara nga kontabiliteti. Po ashtu, të dhënat konfirmuan se pjesëmarrësit kanë qëndrime mjaft pozitive lidhur me kontabilitetin bujqësor dhe rolin e tij në menaxhimin e ndërmarrjeve bujqësore, duke potencuar se e ardhmja dhe menaxhimi i biznesit, shihet përmes pasqyrës së kontabilitetit, dhe se informimi i mëtutjeshëm për rolin e kontabilitetit, duhet të prioritizohet. Si rezultat, janë dhënë rekomandime aplikative dhe shkencore, për të avancuar rolin e kontabilitetit në ndërmarrjet bujqësore në Kosovë.

Fjalë kyçe – Kontabiliteti i menaxhmentit, ndërmarrje bujqësore, menaxher, kontabilist.